VENDIM
Nr. 106, datë 18.8.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "ENERGY SUPPLY" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 6, DATË 2.2.2011

Në mbështetje të neneve 16; 20 germa "b", dhe 110 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4 pika 1 germa "g"; 10 pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1 germa "a", të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.08.2015, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Energy Supply" sh.p.k. për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Energy Supply" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/10 germa "c") janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me: Sasinë e energjisë elektrike të parashikuar që t'u tregtuar në GWh dhe kapitalin financiar të shoqërisë (neni 9, pika 4/10, germat "a" dhe "b"), do të njoftohet subjekti që në bazë të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Energy Supply" sh.p.k. për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr .6, datë 2.2.2011.
2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti